



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.

e-mail: contact@pallatirinise.com

www. pallatirinise.com

Dt: 15.09.2026

Në bazë të dispozitave të nenit 7 të Rregullores me nr 1/333 të datës 24.02.2026 për Procedurën e Dhënies me Qira të Hapësirave, dhe pas identifikimit nga Zyra për Marrëdhënie me Klient, Marketing dhe Promocion për hapësirat e lira sipas nenit 12, dhe bazuar në vendimin e datës **15.09.2026**, Kryeshefi Ekzekutiv, **Shpend Bilalli** N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me seli në Prishtinë, me datën **15.09.2026**, shpallim:

FTESË PËR OFERTË

N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A. fton të gjitha subjektet e interesuara:

- Personat juridik (për ushtrim të veprimtarisë – afarizëm),
 - Personat fizik dhe juridik (për depo),
- të aplikojnë për marrjen me qira të hapësirave për një periudhë të caktuar.
Hapësirat e destinuara për persona juridik – hapësira afariste:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi për m²
1.	Lok.Nr. 13,16 / QT6 (ish SPORT- IN)	231.76 m ²	18.92€ Neto
2.	Lok. Nr . 70 / QT36 (ish - Ros Leather)	13.99 m ²	11.87€ Neto
3	Lok. Nr . 71 / QT40 (ish - Ros Leather)	5.98 m ²	11.87€ Neto
4.	Zyre nr. 01 / SU001 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	11.96m ²	10.89 € Neto
5.	Zyre nr. 06 / SU006 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.28m ²	10.89 € Neto
6.	Zyre nr. 07 / SU007 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	12.18 m ²	10.89 € Neto
7.	Zyre nr. 08 / SU008 (Që ndodhet në pjesën A (Llamella A) në nivelin përdhes në pjesën jugore të sallës universal)	11.96 m ²	10.89 € Neto
	DEPOT E SPORTIT		
8.	Depo nr. SU081 (përball trim kabinetit në korridorin e Sallës së Vogël të SportitDEPO NEN SHKALL)	112.5 m ²	3.58 € Neto
9.	Depo nr. SU076 (ish Sigurimit në korridoret e Sallës së Vogël të Sportit)	27.58 m ²	3.58 € Neto
10.	Depo nr. 016/138 / SU058 (ish spor-in)	34.2 m ²	3.58 € Neto

Vërejtje:

Për hapësirat sportive, mund të aplikojnë vetëm federatat dhe klubet sportive, pasi ato janë të destinuara për veprimtari sportive.

Afati i kontratës:

Një (1) vit nga data e lidhjes së kontratës.

Dokumentet që duhet të dorëzohen:

1. Formulari i aplikimit i cili mund të shkarkohet përmes ueb faqes/emailit zyrtar,
2. Kopje e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal me të dhëna përkatëse;
3. Kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të biznesit;
4. Oferta financiare – çmimi për m² (pa TVSH);
5. Vërtetim nga ATK-ja që dëshmon se biznesi është aktiv;
6. Të dhënat e arkës fiskale;
7. Dëshminë e pageses për aplikim në vlerë prej 300 euro e cila paguhet në xhirollogaritë e Pallatit,

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesit më të favorshëm:

1. Çmimi më i lartë se sa çmimi fillestar i shpallur për m²;
2. Tarifa e aplikimit është 300,00 €, e cila paguhet në xhirollogari;
3. **17-08-0206-000-000-56 (NLB)**
4. **20-33-0002-180-440-76 (TEB)**
5. **2415-1306-0000-2579 (PriBank)**

Tarifa kompensohet me faturën e parë të qirasë.

- Nëse ofertuesi i përzgjedhur tërhiqet nga kontrata, tarifa nuk i kthehet.
- Ofertuesve të pazgjedhur, tarifa u kthehet.

Ofertat nuk do të merren parasysh në rastet kur:

1. Ofertuesi ka qenë qiramarrës i papërgjegjshëm më parë;
2. Oferta nuk përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Oferta arrin pas datës dhe orës së përcaktuar.

Afati i dorëzimit të ofertave:

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur më datë **24.09.2026, në ora 11:30** në Zyrën e Arkivës – N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.

Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet:

- Emri i ofertuesit
- Numri i hapësirës
- E-maili zyrtar
- Numri i telefonit

Hapja e ofertave:

Ofertat do të hapen nga Komisioni për Vlerësim në prani të ofertuesve, 10 minuta pas përfundimit të afatit të dorëzimit – pra më **24.09.2026, deri në ora 11:40,** në zyret e Drejtorisë së N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Vizitat në hapësira:

Të gjithë të interesuarit mund t'i vizitojnë hapësirat nga **15.09.2026 deri më 23.09.2026,** çdo ditë pune, nga ora 10:00 – 15:00, duke u lajmëruar te Recepcioni i N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.

Kërkesa / Aplikacioni mund të merret:

- Në e-mail: contact@pallatirinese.com
- Në uebfaqen zyrtare: www.pallatirinese.com
- Fizikisht në Recepcionin e N.P.L. Pallati i Rinisë SH.A.
-

Për më shumë informata, jeni të mirëpritur të kontaktoni me zyrën përkatëse.